



12 KORRIK 2021

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami së bashku me Z. Benjamin Rockwell, Drejtuesin e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit (INL), znj. Mirlinda Krasniqi (INL) si dhe përfaqësueset e Projektit “Reduktimi i çështjeve të prapambetura dhe rritja e efikasitetit të Gjykatës së Lartë”, zhvilloi takime me Kryetarët në Detyrë dhe Kancelarët e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në këto takime u diskutuan sfidat me të cilat po përballen gjykatat, veçanërisht në drejtim të rritjes së numrit të çështjeve të prapambetura dhe gjetjes së zgjidhjeve praktike për të siguruar aksesin efektiv të qytetarëve. Znj. Llagami diskutoi me të pranishmit edhe problematikat e arkivimit të dosjeve gjyqësore, mungesat infrastrukturore në ndërtesat aktuale të gjykatave dhe nevojën për të pilotuar dixhitalizimin e tyre, çfarë do të mundësonte integritetin e dokumenteve.



Aktiviteti u zhvillua në kuadrin e bashkëpunimit të vazhdueshëm me Qeverinë Amerikane për të çuar përpara objektivat e reformës në drejtësi si dhe të zbatimit të Projektit “Reduktimi i çështjeve të prapambetura dhe rritja e Efikasitetit të Gjykatës së Lartë” i cili po vihet në zbatim nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim, i mbështetur financiarisht nga INL në Tiranë.



Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Naureda Llagami mori pjesë në takimin e dytë konsultativ zhvilluar me përfaqësuesit e sektorit privat për të diskutuar mbi rekomandimet konkrete të këtij komuniteti mbi Planin Strategjik të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sistemit gjyqësor për periudhën 2021 – 2023. Në këtë takim, znj. Llagami u shoqërua nga znj. Fatmira Luli, anëtare e Këshillit dhe njëkohësisht anëtare e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Takimi u mundësua në bashkëpunim me Qendrën për Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private (CIPE), me mbështetjen e Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), si pjesë e konsorciumit për fuqizimin e proceseve elektorale dhe politike, (CEPPS) në kuadër të projektit për të mbështetur krijimin e Akademisë së Transparencës SH.B.A-Shqipëri (USATA).

Gjatë fjalës së saj, Znj. Llagami theksoi se mirëpret angazhimin aktiv të sektorit privat dhe e konsideron atë si një shenjë maturie dhe përgjegjshmërie për të kontribuar në reformimin e sistemit të drejtësisë, duke parë përtej interesit imediat dhe vështirësive që lidhen me situatën aktuale të gjykatave. Gjithashtu, Znj. Llagami nuk nguroi për të nënvizuar gatishmërinë e Këshillit për të ndërvepruar me të gjithë subjektet e sistemit të drejtësisë përfshirë këtu edhe sektorin privat si “subjekte të veçanta si të drejtësisë ashtu edhe të shërbimeve të gjykatave”. Një vëmendje të veçantë në fjalën e saj, Kryetarja e KLGJ-së i kushtoi institucionalizimit dhe vazhdimësisë së komunikimit midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sektorit privat, dëshmi e së cilës janë edhe këto takime konsultative. Në përfundim, znj. Llagami shprehu bindjen që përtej institucionalizimit të bashkëpunimit, është me mjaft rëndësi që t’i hapet rrugë edhe mbështetjes organizative dhe financiare të iniciativave konkrete që rezonojnë me prioritetet kryesore të sistemit gjyqësor, të tilla si: projekti i hartës së re gjyqësore, modernizimi, thjeshtëzimi dhe rritja e aksesit në shërbimet gjyqësore, sistemi i menaxhimit të çështjeve, dokumentacionit dhe arkivave, etj.

Në këtë takim, sektori privat u përfaqësua nga Këshilli Shqiptar i Agrobiznesit, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, Shoqata Pro-Eksport, Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë, Unioni i Sipërmarrësve të Rinj, Konfindustria, etj, të cilët adresuan nevojën për rritje të transparencës dhe forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit mes KLGJ-së dhe sektorit privat.

GJYQTARËT E MEDIAVE

Në përmbushje të detyrimeve ligjore si organ përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun, Këshilli ka caktuar në pozicionin e gjyqtarëve për mediat si më poshtë:

Gjyqtari

Vojsava Osmanaj
Edlira Petri
Florjan Kalaja
Iliba Bezati
Dritan Hasani
Enton Dhimitri
Blerona Hasa
Saida Dollani

Juridiksioni

juridiksioni i Apelit Shkodër
juridiksioni i Apelit Tiranë
juridiksioni i Apelit Durrës
juridiksioni i Apelit Vlorë
juridiksioni i Apelit Korçë
juridiksioni i Apelit Gjirokastër
juridiksioni i Apelit Administrativ
juridiksioni i Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar



Në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë është zhvilluar të premten ceremonia e mirëseardhjes dhe fillimit të detyrës së dy anëtarëve më të rinj të trupës gjyqësore, gjyqtarëve Artur Kalaja dhe Asim Vokshi. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, merrnin pjesë edhe Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor Zj. Naureda Llagami, anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfaqësuesi i Presidentit të Republikës Z. Bledar Dervishaj, drejtuesja e EURALIUS Zj. Agnes Bernhard dhe Z. Ben Rockwell, Drejtori i Çështjeve Ndërkombëtare të Drogës dhe Zbatimit të Ligjit.

Gjatë fjalës së mbajtur me rastin e kësaj ceremonie solemne, Zëvendëskryetari i kësaj gjykate Z. Sokol Sadushi shprehu kënaqësinë për emërimin e dy gjyqtarëve të rinj në këtë gjykate, duke theksuar se emërimi i tyre do të ndihmojë jo vetëm në gjykimin e më shumë çështjeve gjyqësore, në të tria fushat (civile, penale dhe administrative) por edhe në krijimin e kuorumit të nevojshëm për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Ai e vlerësoi angazhimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të sjellë gjyqtarët më të mirë në Gjykatën e Lartë, proces i cili kërkon natyrshëm kohë dhe profesionalizëm. Z.Sadushi i uroi suksese gjyqtarëve të rinj në punën e tyre për dhënien e drejtësisë.

Nga ana e saj Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor Zj. Naureda Llagami u shpreh se drejtësia ndryshe vendoset në bazë të disa standardeve të cilave u duhet qëndruar deri në fund. Gjyqësori duhet të ndryshojë imazhin e tij brenda komunitetit dhe sistemit në përgjithësi, për të sjellë më pas promovimin e këtij imazhi tek politika, qeveria, biznesi, qytetarët dhe partnerët ndërkombëtarë. Sipas Zj.Llagami, ka ende rrugë përpara në mënyrë që këto standarde të konsolidohen, pasi më parë një gjyqtar i Gjykatës së Lartë duhet të lobonte në politikë për tu promovuar, sot kemi diferencën e një standardi krejt të ri, të një drejtësie të re.

HARTA E RE NGJYQËSORE


Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vijim të punës për përgatitjen e hartës së re gjyqësore, organizoi në datën 30 shtator 2021, një takim të Grupit Ndërinstitucional të Punës. Në takim morën pjesë përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtarë nga gjykatat e të gjitha niveleve, Zëvendësministri i Drejtësisë z. Klajd Karameta, eksperti ndërkombëtar z. Jesper Wittrup, si dhe përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë që ofrojnë mbështetje teknike për KLGJ-në në këtë proces.

Një analizë e detajuar e të dhënave statistikore të përditësuara, të mbledhura nga gjykatat për vitet 2019-2020, si dhe ndikimi i tyre në hartën e re gjyqësore, u prezantua nga eksperti ndërkombëtar z. Jesper Wittrup. Anëtarët e Grupit të Punës sollën në vëmendje nevojën urgjente për një riorganizim të ri territorial të gjykatave, nisur nga problematikat që po has sistemi gjyqësor, kryesisht lidhur me rritjen e vendeve vakante në gjykata dhe rritjen e ngarkesës së punës.

Kryetari i Grupit të Punës z. Maksim Qoku, shprehu angazhimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe më gjerë, si dhe me partnerët ndërkombëtarë për përfundimin sa më shpejt të hartës së re gjyqësore që synon krijimin e një sistemi gjyqësor sa më funksional, efikas dhe të aksesueshëm.

Ky aktivitet u organizua me mbështetjen e Projektit “Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimi i efikasitetit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë” zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim (EWMI), financuar nga Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL), si dhe Këshilli i Evropës.

Veprimtaria e KLGJ-së (Korrik - Shtator 2021):



- 21 mbledhje plenare
- 154 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 26 akte kolektive, Korrik 2021
 - 1 akte kolektive, Gusht 2021
 - 16 akte kolektive, Shtator 2021
 - 31 akte individuale, Korrik 2021
 - 4 akte individuale, Gusht 2021
 - 60 akte individuale, Shtator 2021

Pjesa tjetër përfshihen rregulla të brendshme, aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare dhe hartimin e aktit nënligjor me karakter normative si dhe udhëzime.

MASAT E MARRA PËR FUNKSIONALITETIN E SISTEMIT GJYQËSOR

- Në kuadër të procesit të vlerësimit etiko profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë 3 muajve të tretë 2021 vendosi miratimin e 20 raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, për 10 gjyqtarë, si parakusht i ekzistencës së dy vlerësime të mëparshme etiko profesionale për gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Këshilli ka vendosur rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 4 pozicione të lira.
- Këshilli ka vendosur ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Daniela Shirka. Ndërkohë ka përfunduar verifikimi i kushteve dhe kriterëve ligjore për 1 kandidat, për procedurën e ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave, për pozicionin e lirë.
- Mbi propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli hapi 1 procedurë ngritjeje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.
- Në fokus të veprimtarisë së tij gjatë këtyre muajve Këshilli ka pasur edhe procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata edhe përmes skemës së delegimit, në të cilën u përfshinë 6 gjyqtarë dhe të transferimit të përkohshëm me pëlqim të 4 gjyqtarëve.
- Me qëllim plotësimit të trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor trajtoi 149 kërkesa për caktimin e 194 gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.
- Këshilli ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të 11 kandidatëve, pasi verifikoi përmbushjen e kriterëve ligjore për rekrutimin e tyre për këshilltar dhe ndihmës ligjorë.

TRANSPARENCA

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar 4 kërkesa për informacion, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar 83 shkresa të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.

Gjatë kësaj periudhe KLJGJ ka vijuar me intensitet angazhimin në fushën e marrëdhënieve me jashtë duke fuqizuar më tej bashkëpunimin me institucione dhe organizata partnere, nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare dhe takimeve dy apo shumë-palëshe, duke e konsideruar si një element tejet të rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve të KLJGJ dhe në funksion të rritjes së efikasitetit, transparencës dhe pavarësisë së gjyqësorit.

Një zhvillim i rëndësishëm është edhe rritja e bashkëpunimit me institucione qeveritare dhe të pavaruara si Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, organet e rivlerësimit kalimtar, etj.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile mbetet një prioritet i rëndësishëm i aktivitetit të KLJGJ dhe ka shënuar një rritje cilësore të anagzhimit nëpërmjet konsultimeve të hapura për çështje të tilla si Plani Strategjik i KLJGJ-së, harta e re gjyqësore, etj. Zhvillime pozitive ka pasur edhe në marrëdhëniet e KLJGJ-së me median duke e bazuar këtë në raporte të hapura dhe transparente.

KLJGJ ka vijuar të ketë një qasje proaktive në forumet dhe grupet e punës ku merr pjesë në funksion të integritimit evropian dhe të zbatimit të reformës në drejtësi duke dhënë një kontribut të vlerësuar gjerësisht. Po ashtu ka vijuar intensivisht shkëmbimi i informacioneve dhe i raportimeve periodike me Komisionin Evropian, CEPEJ, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, etj.





KLGJ FACEBOOK

Ndjekës në total

1150

-na ndiqni-

Adresa: Godina “Poli i Drëjtësisë”, Rruga “Ana Komnena”, Tiranë

www.klgj.al

email: kontakt@klgj.al